VENDIM
Nr. 495, datë 26.6.2026

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 707, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE SHKODËR–FIER", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 20 të shtojcës, që i bashkëlidhet vendimit nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier", të ndryshuar, shtohet prona e paluajtshme me nr. 284/5, me vendndodhje në zonën kadastrale 3774, sipas të dhënave të përcaktuara në shtojcën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim përdorimin për zhvillimin e qëndrueshëm në turizëm.
2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

SHTOJCË

20. Zona kadastrale 3774, Kavajë (Vilë Bashtovë)

ZK	Nr. pasurie	Vol.	Faqe	Lloji	Sip. m^2 ose ha	Pronësia
3774	284/5	13	25	ranore	294 845	shtet